

SINDROMI I SHAMISË, PRESIDENTJA DHE ZGJEDHJET

Kontribuar nga Administrator
Dienstag, 05 November 2013

Mr. Muhidin Ahmeti

Debati për shaminë dhe shtetin laik të Kosovës arriti madje edhe deri te presidentja e Kosovës. Përfshiu edhe majën e shtetit. Debati për shaminë është ndër debatët më të nxehta jo vetëm në Kosovë, por edhe në gjithë Evropën e edhe më gjerë. Në njëfarë mënyrë është bërë problem global dhe pikërisht ky globalizim i shamisë i jep vlera të paçmuara atyre vajzave dhe nënave muslimane që e mbartin atë. Duhet të jemi mirënjohës ndaj presidentës së Kosovës, e cila e ngriti vlerën e shamisë deri në nivelet më të larta shtetërore duke e aktualizuar atë dhe duke i goditur edhe njëherë muslimanët për t'i zgjuar nga letargjia dhe indiferentizmi ku kanë rënë.

Popujt të cilët janë në gjumë dhe letargji duhet goditur fortë për t'i zgjuar nga gjumi dhe paralajmëruar për zjarrin që po uafrohet. Kam shpresën se ajo duke goditur në mënyrë të prerë arsimin e vajzave që mbi kokat e tyre mbartin shami, njëkohësisht të ketë goditur edhe kokat e djemeve dhe burrave muslimanë, imamët, xhematët dhe komunitetin musliman të Kosovës. Duke dëgjuar një reagim të një imami lidhur me deklaratat e presidentës për shaminë më bënë përshtypje disa refleksione, të cilat për mendim tim pasqyrojnë realitetin dhe mentalitetin e një pjesë të konsiderueshme të muslimanëve në Kosovë qofshin ata nga popullata e thjeshtë apo "elita" fetare. Pyetjet e tilla si "përse ata nuk na njohin vlerën dhe peshën", përse na diskriminojnë në baza fetare, na shtypin, i cenojnë të drejta e garve tonë, na trajtojnë në këtë mënyrë sikur të ishim pakicë e jo shumicë, ne jemi mbi 90% etj. etj., për mendimin tim janë një reflektim dhe tregues i qartë i asaj çfarë po ndodh jo kohët, por edhe vitet dhe dekadat e fundit në Kosovë dhe te shqiptarët në përgjithësi. Qasje e gabueshme ndaj sfidave dhe realitetit. Ne, si muslimanë, shpesh, për shkak të subjektivitetit, jemi të prirë që për moseset tona ose disavantazhet tjera të fajsojmë faktorët e jashtëm (të tjerët), duke ikur sa më shumë është e mundur nga ballafaqimi me mangësitë tona personale. Duke dashur ta mbrojmë me çdo kusht paraqitjen pozitive që e kemi për veten, zhvillojmë një spektër të tërë mekanizmash për t'u shmangur vetëkrikës së thellë dhe ballafaqimit me boshlleqet në personalitetin tonë dhe në komunitetin tonë. Kjo qasje quhet qasje nga jashtë brenda (outside-in) dhe manifestohet në të kërkuarit e alibive në faktorët e jashtëm për vendumrimin tonë.

Qasja tjetër ndaj sfidave jetësore është qasja nga brenda jashtë (inside-out) dhe nënkupton formimin maksimal të vetes dhe ndërrimin e personalitetit vetanak. Fuqia e kësaj qasjeje qëndron në bindjen që njeriut askush nuk mund t'i bëjë dhunë, përveç nëse ai/ajo e lejon vetë atë. Nga ana tjetër, nuk mundet askush ta trupërojë njeriun dhe t'i shaktojë dëm aq sa mund ai t'i bëjë vetes së tij. Prandaj, vëllëzër të dashur, të dobëtin askush nuk e respekton, për të dobëtin askush nuk ka mëshirë. I dobëti as te Zoti nuk është i preferuar. Të dobëtit nuk i duhet mëshira, a ka nevojë për fuqi. Të drejta e njeriut nuk janë donacione që u jepen njerëzve si dhuratë. Ato duhet të fitohen me dije dhe punë, me angazhim dhe vetëmohim duke vepruar vazhdimisht në mënyrë proaktive për realizimin e tyre. Nuk mund t'na respektojnë të tjerët përderisa ne nuk respektojmë veten tonë. Nuk mund ta njohin vlerën dhe peshën tonë të tjerët nëse në si imamë dhe si komunitet muslimanë nuk jemi të vetëdijshëm për vlerën, peshën, fuqinë dhe potencialin që na i ka dhënë Zot i madhërishtëm. Është po ai i njëjti potencial që Zoti i i lartësuar ua dha gjeneratave të para të muslimanëve. Mirëpo, gjeneratat e para të muslimanëve dallojnë nga të sotmet sipas asaj që individët e tyre kanë qenë njerëz të mëdhenj (sipas potencialit, ambicieve dhe interesimit), të cilët erdhen që ta bëjnë të lumtur këtë planet të vogël, ndërsa muslimanët e sotëm janë njerëz të vegjël (sipas dëshirave, interesave mesquine dhe frikave), të cilët kanë ardhur të kërkojnë lumturi në këtë planet të madh. Për qasja e fundit është një shembull i dhunës moderne që e bën njeriu ndaj vetvetes, meqë me vetëdëshirë nëvlerëson potencialin e intelektit dhe shpirtit të tij të dhënë nga Zoti duke e pranuar pozitën e mjerueshme të të nështruarit. Vetëm personat me qëndrim mendor proaktivë – të cilët tmerrohen të jetojnë sipas parimit të topave reaktiv të biliardos që përcaktohen dhe formohen nga ngjarjet aktive mondane – e plotësojnë përkufizimin e personaliteteve të fuqishme dhe e justifikojnë banimin e tyre në këto hapësira.

Tash e kanë radhën imamët që në hutbet dhe ligjëratat e ditës së xhuma, të vetëdijësojnë xhematin e tyre për realitetin e kësaj kohe dhe për goditjet që po i bëhen të drejtave fetare e njerëzore ndaj popullatës kosovare, të proviniençës islame.. Tash e kanë rastin imamët që në zgjedhjet lokale të dëshmojnë veten duke vetëdijësuar dhe sensibilizuar në radhë të parë veten e pastaj edhe xhematet e tyre dhe që të gjithë së bashku të qëndrojnë fuqishëm në nivelin e detyrës. E detyra e të gjithëve bashkërisht është që të mos sillemi indiferentë dhe me neglizhencë ndaj politikës dhe proceseve politike. Deviza e B. Islame se imamët nuk duhet të merren me politikë është e qëlluar, por është gabim të ndalohen imamët të bëjnë politikën e tyre si brenda B. Islame po ashtu edhe në raport me shoqërinë dhe shtetin. Nga ana tjetër, nëse pohon se imamët duhet të merren me politikë, përsëri nuk është gabim, sepse të merresh dhe të angazhohen me/në politikë do të thotë të merrësh me atë që e përmirëson gjendjen ekzistuese. Ndrësa, nga ana tjetër, nëse ti nuk merresh me politikë, ajo do të merret me ty. Ajo do të menaxhojë jeten tënde, standardin jetësor, të drejtat dhe liritë tuaja! Këtu është me rëndësi të citojmë dy hadithe të Profetit

(s) në të cilët thuhet se nuk është musliman ai që nuk interesohet dhe nuk angazhohet për problemet e bashkësisë së tij dhe që më i miri musliman është ai që është më i dobishëm për shoqërinë. Janë imamët pro përmirësimit të gjendjes ekzistuese të muslimanëve apo nuk janë?! Situata në të cilën jetojmë, problemet e grumbulluara, shkelja e të drejtave dhe lirive të besimtarëve muslimanë, sulmet e vazhdueshme mbi identitetin tonë fetar si dhe situata e vështirë në përgjithësi, flet më së miri se ne duhet të ndryshojmë qasjen tonë ndaj politikës dhe partive politike. Është fakt i pakontestueshëm se muslimanët në këtë shtet, ndonëse jemi në shek. 21, akoma nuk mirëkuptohen dhe nuk akceptohen në mënyrë të drejtë. Atyre nuk u mundësohet t'i gëzojnë frytet e lirisë, barazisë dhe demokracisë si të gjithë të tjerët, por ata shikohen si element i huaj, si rrezik potencial, kështu që mbi këto baza sillen vendime kundër tyre, të cilat në vend se t'i avancojnë ua nxijnë dhe u vështirësojnë jetën e tyre.

Imamet dhe xhemati kosovarë duhet të jenë të udhëzuar në realitetin e ri që po krijohet në Kosovë dhe në botë dhe në rrjedhat e ngjarjeve përreth tyre, sepse pasiviteti, indiferentizmi dhe mosinteresimi nuk janë rruga e vërtetë e besimtarit. Vetëm ata që janë ambiciozë mund ta ndryshojnë botën, e ndryshimi është më së i nevojshëm, i domosdoshëm nëse dëshirojmë një të ardhme më të mirë. Ky ndryshim është i patjetërsueshëm në tre rrafshë: në sistemin e korruptuar politik (ariu), në sistemin e padrejtë ekonomik (ujku) dhe në bashkësitë politronike fetare (dhelpira). Ky shtrëngim i trefishtë i personifikuar në sitemet e lartpërmendura, me sukses e mban në frikë të shtresëzuar dhe në ngërç individin e frikësuar (lepurin) që është fshehur në thellësitë e vrimës së lepurit duke britur për ndihmë në procesin e patjetërsueshëm të daljs nga errësira e vetmisë dhe frikës për t'u transformuar në një zog të lirë i cili do të shkëputet dhe largohet përtej zingjirit ushqyes të sistemeve ekzistuese.

Politika është së tepërmi e rëndësishme që t'ua lëmë në dorë individëve të papargjegjshëm dhe të pavetdijshëm, si A. Jahjaga e shumë të tjerë, të cilët çështjen më të rëndësishme në jetë e kanë interesin e tyre personal, për të cilin janë të gatshëm të bëjnë gjithfarë kompromisësh, duke përfshirë edhe ato që shkojnë në dem jo vetëm të një pjesë por të të gjithë popullit. Nuk mund t'ju lihet politika atyre, mbi bazën e të cilëve njëriëzitet e ndershëm kanë sjell një përfundim që "politika është gënjeshtër më e madhe" duke u distancuar prej saj, sepse angazhimi dhe pjesëmarrja në politikë është e vetmja mënyrë që të ndikohet në sjelljen e vendimeve me rëndësi jetësore. Një thënie popullore thotë: "Në qoftë se të ndershmit dhe të mirët nuk verpojnë, të këqinjët do të lulzojnë."

Vizatojeni në formë diagrami linjën tuaj jetësore deri më sot dhe shikojeni për çfarë misioni po ju pergatit All-llahu (xh. sh). A kemi lindur që të hiqemi zvarrë në margjinat e historisë që të hamë mbeturinat e djathit në vrimat e tij, të shplajmë pluhurin nga këmbët e atyre që sjellin ligje kundër nesh dhe që shkelin pa rezistencë mbi ne, mbi të drejtat tona, apo jemi këtu si irritues të shëndetshëm në brendësinë e një gëzhgjë (shoqërie) të caktuar. Një pjesë madhe e muslimanëve (por edhe një pjesë e konsiderueshme e imamëve, shoqatave dhe bashkësive) janë të bindur se gëzhgjat janë ambienti i tyre i paracaktuar i të jetuarit dhe që mbështjellja në gëzhgjë është e vetmja mënyrë për ta ruajtur pastërtinë e besimit (fesë) së tyre, duke ua lënë një hapësirë kolosale për veprim njerëzve të ideologjive tjera. Qëndrimi i muslimanëve ndaj vetes së tyre dhe të tjerëve në historinë më të re në mënyrë të mrekullueshme është përshkruar me një aforizëm elokuent satirik të autorit boshnjak Ramiz Letiq. Ai aforizëm thotë: " O mu'min, rri pupas (galiç) - është nevoja madhe" - e kjo pasqyron reagimin më të shpeshtë të individëve dhe kolektivëve muslimanë karshi sfidave të jetës, e kjo është strategjia e popullit të Nuhit e futjës së kokës në rërë."

Prandaj, prej neve muslimanëve kërkohet dhe na vihet si obligim ta ruajmë krenarinë dhe dinjitetin tonë fetar e kombëtar e të mos lejojmë që të na rrezikohen ato. Si muslimanë duhet sa më parë të çlirohemi nga shpirti apologetik në raport me fenë tonë. Muslimani duhet të jetojë kokëllartë dhe krenar pse është i tillë. Ne asnjëherë nuk duhet t'i lejojmë vetes nënçmimin, poshtërimin dhe përlulësinë, sepse Pejgamberi a.s ka thënë:

"Kush pajtohet vullnetarisht me poshtërimin, ai nuk bën pjesë në radhët tona."

All-llahu i lartësuar e nderoi dhe e lartësoi ummetin musliman duke i dhënë begatinë më të madhe të pazëvendësueshme Islamin. Islamin Ai e bëri udhëzim dhe rrugë të drejtë. H. Omeri pati thënë: "All-llahu na ngriti dhe na lartësoi me islamin, kush dëshiron të lartësohet me diçka tjetër, All-llahu do ta poshtërojë."

Nuk kemi të drejtë në mjerimin tonë të sotëm të mburremi me lavdinë tonë të shkuar. Por, na duhet patjetër të kuptojmë që indiferentizmi, neglizhenca e jonë e muslimanëve e jo mangësia e mësimin islam, ka shkaktuar mjerimin tonë të tanishëm.

Prandaj, të dashur vëllezër, tanimë është koha që ne muslimanët të vëmë në vend dinjitetin tonë kulturor dhe fetar, që të mos jemi objekt për shfrytëzim, por subjekt krijues. Çdo njeri aktiv deri në fund të jetës është "under construction" dhe në qoftë se

dëshiron të shndërrohet në një godinë luksoze intelektuale-morale, e cila me qëndrueshmërinë dhe bukurinë e saj të lë pa frymë, duhet të dijë t'i dëgjojë kritikuesit e vet, e të konsultohet me arkitektët e identiteti të tij.

Duhet kuptuar dhe pranuar se, nën fushatën agresive mediatike globale e drejtuar kundër muslimanëve në dekadën e fundit, janë indoktrinuar individë të shumtë të rritur, ashtu që përsëritja adoleshente e epiteteve, të cilat i dëgjojnë në media duhet trajtuar me durim dhe dinjitet.

Shikuar nga ana tjetër, personalitete të fuqishme dhe karizmatikë nuk ka pa një përvojë të dhimbshme të stigmatizimit, i cili është aty që t'i bëjë të mprehta shqisat tona, të aktivizojë krenari të shëndetshme dhe të nxis për një rritje dhe zhvillim më të shpejtë. Të gjithë ne si fëmijë kemi ëndërruar që një ditë do të bëhemi heronj, të cilët e ndërrojnë dhe e shpëtojnë botën, e heronjtë asnjëherë nuk kanë lindur në kushte idilike. Ata të cilët nga monotonia, miopia (shkurtpamësia) apo intoleranca na stigmatizojnë, janë dërguar në jetët tona për të forcuar karakteret tona, për t'i mprehur shpirtat tonë dhe për t'i forcuar artikullimin e qëndrimeve tona – dhe për ne si të tillë janë me vlerë prej ari.

Në fund të këtij shkrimi nuk mund të lë pa i cituar këtu para jush disa ajete kur'anore që flasin rreth aktiviteteve politike të muslimanëve:

“O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të All-llahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj disa njerëzve e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kini dro All-llahun se All-llahu di hollësisht për atë që vepron. “ (El-Maide, 8)

“O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmues të drejtë për hirë të All-llahut edhe nëse është kundër (interesit) vetvetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmeve, le të jetë ai (për të cilin dëshmohet) pasanik ose varfnjak, pse All-llahu di më mirë për ta. Mos ndiqni pra emocionin e t'i shmangeni drejtësisë. Nëse shtrëmbëroni ose tërhiqeni, All-llahu hollësisht di ç'ka punoni.” (En-Nisa', 135)

“Zoti ju urdhëron që punët me përgjegjësi t'ua besoni atyre që janë të denjë për to, dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me drejtësi në mes njerëzve` Sa e mirë është kjo që ju këshillon. All-llahu dëgjon dhe sheh si vepron. O ju që besuat, binduni All-llahut, respektoni të dërguarin dhe përgjegjësit nga ju. Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrojeni atë te All-llahu (te libri i Tij) dhe te i dërguari, po qe se i besoni All-llahut dhe ditës së fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë.” (En-Nisa', 58-59)

Në vend të përmbylljes: Disa nga urdhërat e parkourit mendor:

1. Mos kërkoni qendra të fuqisë nëpër botë, sepse Ai është mbi ju dhe pret prej jush që të bëheni inteligjenca qendrore e kohës suaj;
2. Kapërceni muret kohore dhe hapsinore me një devocion dhe disiplinë të tillë ashtu që masat e mëdha morale dhe intelektuale nga fillimi deri në fund të botës, do të dëshironin t'ju takonin në botën e ardhshme;
3. Bëhuni qendra të fuqisë në planin ndërnjerëzor, të cilët do të edukonin njerëz-institucione, ndërtesat të objekteve institucionale;
4. Fryjini çdo gjëje rreth vetes nga fryma juja e kultivuar në atë mënyrë siç u fry në ju në procesin e ringjalljes së baltës;
5. Ndërprejani ushqimin lugetërve bashkëkohor, të cilët ushqehen me frikat tuaja;
6. Bëhuni çmontues të mureve të montuara të kompleksit të inferioritetit;
7. Vëzhgoni miliona mënyra nëpërmjet të cilave Zoti fascinon çdo gjë të gjallë me kreativitetin e Tij dhe zgjidheni të paktën një që edhe ju të fascinoni botën.

Referencat:

1. Edin Tule , trilogjia e librave: dimensionet socio-psikologjike të Kur'anit, trajtimi kur'anor i stresit dhe parkouri mendor...
2. www.sites.google.com
3. www.novihorizonti.ba